

URDHËR
Nr. 45, datë 9.2.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 408, DATË 22.8.2011 “PËR HAPJEN E
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË: “GAZETARI
KOMUNIKIM”, “SOCIOLOGJI-ANTROPOLOGJI SOCIALE”; PROGRAMEVE TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË “SHKENCA EDUKIMI”;
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” NË
“INFORMATIKË E APLIKUAR”, “MËSUESI” “SOCIOLOGJI E APLIKUAR” TË
INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË PRIVAT “UNIVERSITETI EUROPIAN I
TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 42/1 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pika 2 e urdhrit nr. 408, datë 22.8.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, ndryshon si më poshtë:

“2. Hapjen, në përputhje me vendimin nr. 210/1, datë 29.7.2011 të Këshillit të Akreditimit, në institucionin e arsimit të lartë privat “Universiteti European i Tiranës”, e të programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Shkencat e edukimit”, me profile:

- a) Politikat e edukimit,
- b) Administrim shkollor.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe shkolla e lartë private “Universiteti European i Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj